

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Fredy Electronic shpk" është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe regjistruar në QKB date 03.06.2009.

Selia e shoqërisë është në adresën, rruga e Kavajës te 21 Dhjetori, godina 207.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga aksione me vlerë nominale 100,000 Lek, zotruar i se ciles është Ortaku i vetëm i shoqërisë z. Alfred Kasmi.

Administrator i shoqërisë është Z. Alfred Kasmi.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është: Import, tregëtim i pajisjeve elektronike, elektrike etjeter, si dhe shërbimet që kryhen në këto fusha.

Numri mesatar i punëmarrësve për vitin 2019 është: 8 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

- Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.
- Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të kostatuara.
- Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.
- Kuptueshmëria e pasqyrave financiare është realizuar për të qenë të qarta dhe të lexueshme nga përdorues të jashtëm.
- Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e besueshmërisë dhe besnikërisë dhe paraqitjen e drejtë të PF.
- Për përcaktimin e kostos së inventareve është zgjedhur metoda e kostos mestare të ponderuar.
- Vlersimi fillestar i aktiveve afatgjate është vlersuar me kosto historike. Për llogaritjen e amortizimit janë vendosur përqindjet që janë aktualisht në legjislacion. Për ndërtesat 5%, për AAJM 15%, me metodën lineare. Pajisjet elektronike 25%, dhe gëtithe të tjerat 20% mbi vlerën e mbetur.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Mjetet monetare



Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3.2 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.3 Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3.4 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

3.5 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



3.6 Aktive afatgjata materiale

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| Mobilje për zyren | Vlera e mbetur | 20 % |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25 % |
| Të tjera | Vlera e mbetur | 20% |

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.7 Detyrimet afatshkurtra

Njohja e detyrimeve afatshkurtra financiare, matja fillestare dhe vlerësimi i mepasshëm i tyre realizohet dukembajtur në konsideratë kërkesat e SKK e permiresuar nr 3 "Instrumentata Financiare", paragrafet nr 11-21. Per vlerësimin e tyre është përdorur metoda e koston se amortizuar, Perktimi i instrumentave financiare tepagueshem ne monedhe te huaj me kursin e dates se raportimit,



3.8 Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel ne perputhje me SKK nr 1 "Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare" e permiresuar, SKK nr 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SKK nr 8 "Te Ardhurat" per njohjen dhe evidentimin e rezultatit neto te periudhes ushtrimore.

3.9 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.



A - Bilanci Kontabel, Aktivet

1 Mjete monetare

Mjetet Monetare ne dt. 31 Dhjetor jane shprehur në njësinë monetare kombëtare. Vlerat monetare ne monedhe te huaj jane konvertuar sipas kursit te dates 31 dhjetor perkatesisht:

1 Euro = 121.77 lek

1 Dollar = 108.64 lek

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|-------|------------------|------------------|
| Arka | 6,621,666 | 111,540 |
| Banka | 542,584 | 1,188,765 |
| | <u>7,164,250</u> | <u>1,300,305</u> |

2 Kerkesa te Arktueshme

Kerkesa te Arktueshme jane te gjitha te drejtat ,qe lindin nga aktiviteti i shfrytzimit ndaj klienteve per shitjen e mallrave, produkteve dhe sherbimeve , me arketim te mevonshem.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|---------------------------------|-------------------|-------------------|
| Kliente per mallra dhe sherbime | 15,978,773 | 13,629,588 |
| Total | <u>15,978,773</u> | <u>13,629,588</u> |

3 Kerkesa te tjera te Arktueshme

Kerkesa te tjera te Arktueshme jane tepricat e llogarive si: te drejta ndaj personelit, individeve, shtetit per tatim taksa, debitore te tjere, ndaj pjesmarrjeve dhe shoqerive te grupit qe klasifikohen si afatshkuter.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|---|------------------|------------------|
| Tvsh | 279,153 | - |
| Tatim Fitimi | - | 462,112 |
| Parapagime per zhdoganim mallarsh(Dogane) | 282,263 | 395,375 |
| Parapagime per qera | - | - |
| Depozite sigurie per qera | - | - |
| Total | <u>561,416</u> | <u>857,487</u> |

4 Inventarët:

Ne kete ze jane inevtaret e mallrave per rishitje , materialeve , prodhimit ne proces, produkteve te ndermjetem dhe ato te gatshme ne dt. 31 Dhjetor

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|--------------|-------------------|-------------------|
| Mallra | 36,656,401 | 29,534,077 |
| Total | <u>36,656,401</u> | <u>29,534,077</u> |

5 Aktivet materiale:

Gjendja e Aktiveve Afatgjate Materiale ne dt. 31 dhjetor paraqitur me vleren e tyre Neto (Kosto minus amortizim minus ndonje zhvlersim te mundshem)

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|--------------------------------|------------------|------------------|
| Impiante dhe makineri | 279,851 | 349,815 |
| Të tjera Instalime dhe pajisje | 443,517 | 443,993 |
| Total | <u>723,368</u> | <u>793,808</u> |



B - Bilanci Kontabel, Pasivet

6 . Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----------------------|------------------|------------------|
| Overdrafte | 7,844,637 | 7,871,485 |
| Kredi afatshkutterra | - | - |
| Total | 7,844,637 | 7,871,485 |

7 . Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit janë: detyrimet tregtare te njesise ndaj te treteve per mallra, produktet dhe sherbimet e blera por te papaguara si dhe detyrime te tjera qe lidhen me aktivitetin e shfrytëzimit

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|--------------------------------|-------------------|-------------------|
| Te pagueshme ndaj furnitoreve | 13,973,821 | 12,319,936 |
| Arkëtimet në avancë për porosi | - | - |
| Total | 13,973,821 | 12,319,936 |

8 . Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore janë detyrimet ndaj punonjesve per pagat dhe detyrimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|---------------------------------------|----------------|----------------|
| Detyrime per Pagat | 480,571 | 271,600 |
| Detyrime per Sig Shoq dhe shendetsore | 82,755 | 75,200 |
| Total | 563,326 | 346,800 |

9 . Të pagueshme për detyrimet tatimore

Ta pagueshme per detyrimet tatimore jane te gjitha llojet e tatimeve dhe taksave te llogaritura e te papaguara ndaj institucioneve shteterore dhe vendore si tvsh,tatim fitim,akciza,tatim mbi te ardhurat personale,tatim ne burim dhe te tjera

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----------------|----------------|----------------|
| Tap | 7,800 | 6,500 |
| Tatim ne burim | 4,500 | 4,500 |
| Tvsh | - | 626,432 |
| Tatim Fitimi | 133,017 | - |
| Total | 145,317 | 637,432 |

10 . Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme janë detyrimet te ndryshme ndaj ortakeve dhe aksionerve ,perfshire detyrimin per dividendin.

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|------------------------|------------------|------------------|
| Detyrime ndaj Ortakeve | 7,244,262 | 6,103,943 |
| Total | 7,244,262 | 6,103,943 |

11 . Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Kredi afatgjate nga institucionet bankare ne daten 31 Dhjetor te vitit te mbyllur ushtrimor

| | Viti 2019 | Viti 2018 |
|-----------------------------|------------------|-----------|
| Kredi afatgjata nda bankave | 8,000,000 | - |
| Total | 8,000,000 | - |



12 . Kapitali dhe Rezervat

Kapitali eshte diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve e detajuar sipas zerave

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|-------------------------------|--------------------------|--------------------------|
| <i>Kapitali i Nënshkruar</i> | 100,000 | 100,000 |
| <i>Rezerva ligjore</i> | 21,856 | 21,856 |
| <i>Rezerva të tjera</i> | 18,713,813 | 15,984,193 |
| <i>Fitimi i pashpërndarë</i> | - | - |
| <i>Fitim / Humbja e Vitit</i> | 4,477,176 | 2,729,620 |
| Total | <u>23,312,845</u> | <u>18,835,669</u> |

C - Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

13 . Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Ne kete ze jane paraqitur te Ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|--|--------------------------|--------------------------|
| <i>Te ardhura nga shitja dhe sherbimet</i> | 37,161,471 | 25,019,708 |
| Total | <u>37,161,471</u> | <u>25,019,708</u> |

14 . Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Ne kete ze paraqiten kostoja e mallrave, lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara qe lidhen me veprimtarine e shfrytëzimit.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|--|----------------------------|----------------------------|
| <i>Kosto e mallave dhe materialeve</i> | (24,102,708) | (15,575,660) |
| Total | <u>(24,102,708)</u> | <u>(15,575,660)</u> |

15 . Shpenzime të personelit

Ne kete ze paraqiten pagat dhe shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|---|---------------------------|---------------------------|
| <i>Shpenzime per paga</i> | (3,387,607) | (3,047,600) |
| <i>shpenzime per sigurimet shoq & shendetsore</i> | (562,250) | (505,897) |
| Total | <u>(3,949,857)</u> | <u>(3,553,497)</u> |

16 . Shpenzime amortizimi

Ne kete ze paraqiten amortizimet per secilin grup.

| | Norma ne % | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|--------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------------|
| Ndertime | 5% | - | - |
| Makineri, paisje | 20% | (47,008) | (58,760) |
| Mjete transporti | 20% | (22,956) | (28,695) |
| Paisje zyre | 20% | (14,703) | (15,880) |
| Paisje Informatike | 25% | (99,439) | (31,260) |
| Total | | <u>(184,106)</u> | <u>(134,595)</u> |



- 17 . Shpenzime të tjera shfrytëzimi
Ne kete ze paraqiten shpenzimet e tjera te shfrytëzimit ne menyre analitike.

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|-----------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Shpenzime per qira | (1,020,000) | (960,000) |
| Shpenzime mirmbajtje dhe riparime | (17,500) | (12,500) |
| Shpenzime per siguracione | (130,991) | (80,600) |
| Shpenzime utilitare te tjera | (1,009,414) | (584,085) |
| Shpenzime udhetim e djeta | (386,775) | (59,645) |
| Shpenzime postare dhe telekomuni | - | (23,250) |
| Shpenzime transporti | - | - |
| Shpenzime për shërbimet bankare | (364,040) | (114,717) |
| Taksa, tatime dhe tarifa vendore | (307,400) | (304,400) |
| Gjoha dhe dëmshpërblime | (128,623) | (36,891) |
| Total | <u>(3,364,743)</u> | <u>(2,176,088)</u> |

- 19 . Shpenzimi I tatimit mbi fitimin

| | <u>Viti 2019</u> | <u>Viti 2018</u> |
|----------------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Fitimi/Humbja para tatimit | 5,289,964 | 3,267,865 |
| Shpenzime te panjohura | 128,623 | 538,245 |
| Fitimi/Humbja e tatueshme | <u>5,418,587</u> | <u>3,806,110</u> |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | (812,788) | (538,245) |
| Fitimi/Humbja e vitit | <u>4,477,176</u> | <u>2,729,620</u> |

Per "FREDI ELECTRONIC" Shpk"

ADMINISTRATOR
Alfred KASMI



Hartuesi
FEAL STUDIO Shpk
Ferit Karaj

